



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ prot.

Datë ____/____/2018

V E N D I M

Nr. 50 , Datë 07 / 02 / 2018

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bazuar në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, mori në shqyrtim ankesën nr.144 Regj., datë 08.11.2017, e shtetasit E. A, kundër Drejtorisë së Policisë së Qarkut Vlorë, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “orientimit seksual” dhe të “identitetit gjinor”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I :

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Në ankesën e paraqitur pranë Komisionerit, nga subjekti ankues E. A, pretendohet se në datën 26.10.2017, në orën 15⁴⁰ është paraqitur pranë Drejtorisë së Policisë së Qarkut Vlorë për të depozituar një denoncim kundër një personi, nga i cili është ndjerë i kërcënuar dhe i rrezikuar për jetën e tij. Z.A pretendon se si shkak ka shërbyer një dalje e tij në një nga mediat vizive (tek emisioni “Zonë e lirë”, në Tv Klan). Ankuesi pretendon se nga ana e punonjësve të policisë i është mohuar t’i merrej denoncimi. Ankuesi shprehet se: “...më është refuzuar të më merret denoncimi jo vetëm për këtë rast, por dhe në raste të tjera. Arsyeja për të cilën jam paraqitur pranë Drejtorisë së Policisë së Qarkut Vlorë ka qenë së pari, për shkak se kam marrë kërcënime në adresën time në facebook dhe së dyti, për kërcënimet që kam marrë nga një komshi i lagjes në të cilën banoj. Për rastin e kërcënimeve në facebook

nga punonjësit e policisë më është thënë se nuk mund t'i marrim këto denoncime; me justifikimin se nuk kemi strukturë të posaçme për zbulimin e krimit kibernetik në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Vlorë. Për rastin e dytë, denoncimin për komshiun e lagjes ku banoj, i cili dhe më ka sulmuar fizikisht, nuk ma kanë pranuar fare. Lidhur me situatën e mësipërme jam ndier i trajtuar në mënyrë fyese dhe diskriminuese nga ana e punonjësve të policisë, për shkak të orientimit tim seksual dhe të identitetit gjinor”.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10 221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 7 i LMD-së¹, në pikën 1 të tij, parashikon se: “ Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Përsa më lart, referuar nenit 33, të ligjit nr. 10 221/2010, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

¹ Shkurtesë për Ligjin “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

1. Me shkresën nr.1096/1 prot, datë 21.11.2017 të Komisionerit i është kërkuar informacion Drejtorisë së Policisë së Qarkut Vlorë, lidhur me pretendimin e z.A.

Megjithë tejkalimin e afateve të parashikuara në ligj për kthimin përgjigje, ky institucion nuk solli asnjë përgjigje shkresore.

2. Me shkresën me nr.1096/2 prot., datë 22.12.2017 të Komisionerit, Drejtorisë së Policisë së Qarkut Vlorë, i është dërguar sërish shkresë lidhur me informacionin që kërkohej prej tyre.

Me shkresën me nr.245/2 prot., datë 18.12.2017² Drejtoria e Policisë së Qarkut Vlorë ka informuar Komisionerin se: *“...Me datë 13.11.2017 pranë Zyrës së Informacionit të Komisarariatit të Policisë Vlorë është paraqitur shtetasi E. A, i cili ka ankimuar se në datën 13.11.2017, në orët e vona persona të paidentifikuar kanë goditur me gurë në drejtim të banesës së tij. Në ankimin penal ky shtetas sqaron se para disa kohësh ka qenë në një emision televiziv ku ka shprehur hapur orientimin e tij seksual dhe ka kërkuar ndihmë për ndërrimin e gjinisë. Si pasojë e kësaj dalje kur ka ardhur në Vlorë, banesën e tij kanë filluar ta godasin me gurë. Nga ana jonë janë kryer veprimet procedurale dhe me datë 14.11.2017 materialet i janë referuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë për veprën penale të kanosjes parashikuar nga neni 84 i K.Penal”.*

3. Në vijim të procedurës për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës, me datë 18.01.2018³, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, realizoi një inspektim pranë ambjenteve të Drejtorisë së Policisë së Qarkut Vlorë.

Grupi i inspektimit të Komisionerit u takua me Shefin e Komisarariatit Vlorë, z.G. M dhe Specialistin për Krimet, z.E. G, të cilët lidhur me pretendimin e shtetasit E. A sqaruan se pretendimi i tij për mosmarrje kallëzimi nuk është i vërtetë, pasi me datë 13.11.2017 i është marrë ankimi dhe me datë 14.11.2017 materialet i janë dërguar për ndjekje Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë. Për sa mësipër, ata vunë në dispozicion të Komisionerit një kopje të dokumentit provues.

² Protokolluar pranë Komisionerit me shkresën me nr.64 prot., datë 11.01.2018.

³ Në zbatim të Urdhërit nr.6, datë 09.01.2018, të Komisionerit dhe shkresës me nr.34/2 prot., datë 11.01.2018.

Lidhur me rastin e datës 26.10.2017, z.Greku informon se shtetasi në fjalë është pritur tek Zyra e Pritjes së Qytetarit, gjë që pasqyrohet edhe në Librin e ankesave pranë ZSHQ Vlorë. Ai ka ngritur pretendimin se kërkonte të hiqte disa komente fyese dhe diskriminuese nga faqja zyrtare e facebook-t, “Zonë e Lirë”, e cila është në administrim të personazhit publik A. Ç. Z.G shprehet se, pasi konsultuan rastin e kanë këshilluar që t’i drejtohej personit që administron faqen për heqjen e komenteve fyese, si dhe i kanë dhënë një numër kontakti të një specialisti të Sektorit të Kriminologjisë Kibernetik, pranë Drejtorisë së Policisë së Shtetit Tiranë, me qëllim që ta ndihmonin me çdo mënyrë që mundeshin.

III. Në përfundim të procedurave të shqyrtimit të ankesës dhe bazuar në dokumentacionin e administruar, Komisioneri vëren se:

A. Lidhur me pretendimin e ankuesit se është diskriminuar nga Drejtoria e Policisë së Qarkut, Vlorë, për shkak të orientimit të tij seksual dhe identitetit gjinor.

Ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, neni 1 sipërcituar dhe neni 3/1, parashikojnë se: *“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”*

Lidhur me pretendimin e se nga ana e punonjësve të Policisë së Qarkut Vlorë së nuk i është marrë denoncimi për heqjen e komenteve fyese në adresën e tij të facebook-ut, Komisioneri konstaton se:

Së pari, gjatë këqyrjes së “Librit të Kërkesë-Ankesave pranë ZSHQ Vlorë”, pasqyrohet fakti se shtetasi E. A në datën 26.10.2017, në orën 14:58 është pritur nga specialist E. G. Ankuesi ka paraqitur pretendimin se kërkon të heqë komentet fyese dhe diskriminuese nga faqja zyrtare e facebook-ut “Zonë e Lirë”, administruar nga gazetari A. Ç dhe jo nga faqja e tij e facebook-ut.

Së dyti, personat (punonjësit e Drejtorisë së Policisë së Qarkut Vlorë) që e kanë pritur z.A e kanë orientuar atë se për heqjen e komenteve fyese dhe diskriminuese duhet t'i drejtohet personit përgjegjës që administron faqen e facebook-ut.

Së treti, lidhur me këtë, Komisioneri thekson se Ligji nr.10 128, datë 11.05.2009 “Për Tregtinë Elektronike”⁴, parashikon që për sa më lart, është përgjegjësi e menaxhuesit të faqes të marrë masa për filtrimin e komenteve të tilla, kur ka.

Lidhur me pretendimin e se nga ana e punonjësve të Policisë së Qarkut Vlorë së nuk i është marrë denoncimi për kërcënimin fizik të tij, paraqitur me datë 13.11.2017:

Bazuar në dokumentacionin e siguruar gjatë inspektimit pranë Drejtorisë së Policisë së Qarkut Vlorë, Komisioneri konstaton se:

Me shkresën me nr.12183 prot., datë 14.11.2017 e Drejtorisë së Policisë së Qarkut Vlorë, me lëndë: “Dërgohen materiale procedurale për veprën penale të “Kanosjes” parashikuar nga neni 84 i Kodit Penal”, rasti i shtetasit E. A i është referuar për ndjekje të mëtejshme organit të Prokurorisë së Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë.

Bashkëlidhur janë dërguar aktet:

1. Informacion për referimin e veprës penale.
2. Procesverbal për ankimin e të dëmtuarit nga vepra penale.
3. Proceverbal për marrjen e të dhënave.

Pra, siç pasqyrohet nga dokumentacioni dhe faktet konkrete, pretendimi i subjektit ankues për mos marrje ankimi për shkak të orientimit seksual apo identitetit gjinor, nuk qëndron, pasi nga ana e punonjësve të Drejtorisë së Policisë së Qarkut Vlorë janë ndërmarrë të gjitha masat për të përmbushur detyrimin ligjor ndaj ankuesit.

PËR KËTO ARSYE :

⁴ “Kur një shërbim i shoqërisë së informacionit konsiston në ruajtjen e informacionit të siguruar nga marrësi i shërbimit, ofruesi i shërbimit të shoqërisë së informacionit nuk është përgjegjës për informacionin e ruajtur me kërkesën e marrësit të shërbimit, nëse ofruesi i shërbimit:...b) me marrjen e këtij informacioni, vepron menjëherë për të hequr ose çaktivizuar aksesin në informacion.”.

Mbështetur nenet 1, 2, 3, pika 1, neni 4, pika 1, neni 7, pika 1, neni 20, neni 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a), nenin 33, pikat 1, 3, 5, 7 e 10 të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit, për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor, të shtetasit E.A. nga ana e Drejtorisë së Policisë së Qarkut Vlorë.
2. Kundër këtij Vendimi lejohet ankim, brenda afateve ligjore, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Irma BARAKU

KOMISIONERI

(shkaku: orientim seksual, identitet gjinor)
(fusha: të mira dhe shërbime)